



Prishtinë: 18.07.2012

Kodi i ZRRE-së: V_426_2012

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_796_05_2012

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kreu IV, nenit 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_796_05_2012**; dhe
5. Ankesën e konsumatorit me datë 22.06.2012;

Në mbledhjen e mbajtur më 18 korrik 2012, nxorri këtë:

VENDIM

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit Abdullah Ahmeti (shifra në KEK: DPR – 94044) nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_796_05_2012 i datës 05.06.2012.

Arsyetim

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori me datë 12.05.2011 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 3400073 dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 47553670.

Pas dërgimit të njehsorit elektrik në qendrën e kalibrimit, punëtorët e autorizuar të kësaj qendre me datë 16.06.2011 kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 3400073, dhe kanë konstatuar se njehsorit elektrik vula (bllombat) shtetërore i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori dëmtime tjera nuk ka, përreth qelqit nga ana e poshtme është futur shiriti filmik, është pengu puna e diskut dhe në brendi të njehsorit ka pluhur të shiritit filmik.

Departamenti i Faturimit në KEK me datë 18.08.2011 e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR11HP10244 në vlerë prej 456.44€. Pas kësaj ngarkese të bërë nga KEK-u konsumatori me datë 21.04.2011 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike. Departamenti për Konsumator në KEK pas ankesës së bërë nga konsumatori ka shqyrtuar lëndën e konsumatorit dhe ka refuzuar ankesën e tij. Konsumatori pas marrjes së përgjigjes nga ana e KEK-ut, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE me të cilin ka kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 05.06.2012 ka nxjerr vendim duke **refuzuar pjesërisht** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që të shkarkoj konsumatorin nga fatura e rikthimit të humbjeve DPR11HP10244 e datës 18.08.2011 në vlerë 456.44€, dhe të ngarkoj konsumatorin me faturën e rikthimit të humbjeve



duke marrë për bazë vlerën e parë nga fatura DPR11HP10244, pra vlerën prej 40.17€ dhe atë duke u kthyer mbrapa për 5 muaj prej periudhës 01/2011 deri 05/2011.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, më datë 22.06.2012 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, me të cilën ka kundërshtuar në tërësi vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_796_05_12 të datës 05.06.2012.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 18.07.2012 ka shqyrtuar dhe analizuar dëshmitë e paraqitura nga konsumatori, përkatësisht kundërshtimet e theksuara në ankesë ndaj vendimit të DMK-së.

Bordi i ZRRE-së pas shqyrtimit të procesverbaleve të KEK-ut ka vërejtur se punëtorët e autorizuar të KEK-ut me datë 12.05.2011 me rastin e ndërrimit të njehsorit elektrik nuk kanë treguar arsyen e ndërrimit të njehsorit elektrik si dhe nuk kanë evidentuar asnjë dëmtim të jashtëm të njehsorit elektrik. Gjithashtu janë vërejtur edhe mos përputhje në mes procesverbalit të kalibrimit dhe protokollit të shqyrtimit të njehsorit elektrik, ku në procesverbalin e kalibrimit është konstatuar se nga ana e jashtme njehsori dëmtime nuk ka, ndërsa në protokollin mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik nr. 014627 të datës 14.06.2011 është konstatuar se njehsori elektrik është i dëmtuar nga ana e jashtme.

Punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit nr. 3400073, dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik vula (bllobat) shtetërore i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori dëmtime tjera nuk ka, përreth qelqit nga ana e poshtme është futur shiriti filmik, është pengu puna e diskut dhe në brendi të njehsorit ka pluhur të shiritit filmic. Punëtorët e kësaj qendre kanë siguruar edhe fotografitë e qendrës së kalibrimit për njehsorin elektrik nr. 3400073, ku edhe vërehen dëmtimet e cekura në laboratorin e kalibrimit

Bordi po ashtu ka analizuar edhe shpenzimin e energjisë elektrike të konsumatorit e energjisë elektrike me njehsor të vjetër elektrik dhe me njehsor të ri elektrik dhe kanë vërejtur se mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën 08/2002 deri më 05/2011 është 592 kWh/muaj me njehsor të vjetër nr. 3400073, ndërsa mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën 05/2011 deri më 04/2012 me njehsor të ri nr. 47553670 është 424 kWh/muaj. Sipas analizave të shpenzimit të energjisë elektrike sipas viteve vërehet se mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike në shifrën DPR – 94044 ka zbritje të shpenzimit nga viti në vit dhe se kjo zbritje ka vazhduar deri në ndërrimin e njehsorit elektrik, e me ndërrimin e njehsorit elektrike kemi një ngritje të shpenzimit të energjisë elektrike.

Sipas analizës së bërë listave të leximit të KEK-ut është vërejtur se lexuesi i KEK-ut ka evidentuar se nevojitet kontroll për njehsorin elektrik dhe se vula distributive është në rregull.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar faturën e rikthimit të humbjeve DPR11HP10244 të datës 18.08.2011 të përpiluar nga Departamenti i faturimit në KEK dhe konstaton se KEK sha ka gabuar ngase ka përdorur dy vlera, një në vlerë 40.17€ dhe menjëherë në tjetrën në vlerë 65.58€. Pra KEK-ut sipas faturës është dashur ta faturonte konsumatorin me rikthim të humbjeve duke marrë për bazë vlerën e parë dhe e jo vlerën e dytë. Nga analizat e bëra listave të leximit të KEK-ut dhe faturës së rikthimit të humbjeve vërehet se nga periudha 01/2011 lexuesi i KEK-ut ka evidentuar se nevojitet kontroll njehsori dhe se sipas këtyre dokumenteve KEK-u ishte dashur ta kalkulonte faturën e rikthimit të humbjeve për periudhën pesë mujore (01/2011 -05/2011), ashtu siç specifikohet në nenin 32, paragrafi 1 të Rregullës për Kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji elektrike si dhe në nenin 13.1 të Procedurës për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike.



Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 18.07.2012 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. **ZRRE/DMK_V_796_05_2012**, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar